



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-351/02-46868
Dt. 29.04.2026
Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e pronarëve: **Neshat Gashi (qiradhënës) pronarë i ngastrës P-71813046-01923-17 Zk.Lubizhdë në një rënë anë dhe në anën tjetër investitor “Treang SH.P.K” (qiramarrës) sipas kontratës me LRP nr.7717/2025 dhe Ref. nr.2202/2025** me të cilën ka kërkuar leje për ndërtimin e objektit **-Objekt Afarist-Depo** në bazë të nenit 3 alineja 1 pikat 1.7 , 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alinea 1. Pika 1.1 nenin 15 alinea 1 pika 1.1 , neni 18 e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 ,si dhe konform neneve 14,15,16,17 dhe 18 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 , si dhe konform nenit 4 pika 6.1 ,paragrafi 2,dhe paragrafi 14 si dhe pika 6.3 e Rregullores për taksa,tarifa,ngarkesa dhe gjoha nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr.01/011-46063 dt.28.03.2019 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44,46,47,48 si dhe neneve 27 dhe 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 me Nr. 001-011-48192, të datës 31.03.2022, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	<u>Neshat Gashi (qiradhënës) pronarë i ngastrës P-71813046-01923-17 Zk.Lubizhdë në një rënë anë dhe në anën tjetër investitor “Treang SH.P.K” (qiramarrës) sipas kontratës me LRP nr.7717/2025 dhe Ref. nr.2202/2025</u>		
Adresa:	Prizren		
Telefoni:	//	Emaili:	//

Emri i projektit	Objekti –Afarist-Depo
------------------	------------------------------

Emri i projektuesit	"G-Project SH.P.K"		
Adresa:	Rr.Tirana 50-Prizren		
Telefoni:		Emaili:	

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore **Neshat Gashi (qiradhënës) pronarë i ngastrës P-71813046-01923-17 Zk.Lubizhdë në njëriën anë dhe në anën tjetër investitor "Treang SH.P.K" (qiramarrës) sipas kontratës me LRP nr.7717/2025 dhe Ref. nr.2202/2025** i lejohet ndërtimi i objektit: **objekt Afarist-Depo** në ngastrën kadastrale me nr. P-71813046-01923-17 Zk.Lubizhdë.

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	Prizren	
Zonat (t) Kadastrale	<p>Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Lubizhdë dhe sipas HZK-së është i destinuar ZI. Objekti – objekt Afarist-Depo do të ndërtohet në parcelën me nr P-71813046-01923-17 Zk.Lubizhdë me sipërfaqe sipas kopjes së planit është S=1700 m2. Etazhiteti i objektit do të jetë: P+1</p> <p>Sipërfaqja bruto e përdhësës është S=850.0 m². Sipërfaqja bruto e katit është S=842.54 m².</p> <p>Sipërfaqja bruto e objektit është S=1692.54 m².</p> <p>Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej 7,091.75 €.</p> <p>Parallogaria e vlerës së objektit sipas dokumentacionit teknik është në shumën prej 710,956.74 €</p>	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar: Ndërtimi i ri <input checked="" type="checkbox"/> Rindertim <input type="checkbox"/> Ripatim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndertimeve te propozuera: Kategoria I Kategoria II <input checked="" type="checkbox"/>
A perfshin kerkesa ndryshimin e destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Perdorimi i propozuar:objektit- objekt afarist-depo



Me këtë vendim, poseduesit të lejes Neshat Gashi (qiradhënës) pronarë i ngastrës P-71813046-01923-17 Zk.Lubizhdë në njërën anë dhe në anën tjetër investitor “Treang SH.P.K” (qiramarrës) sipas kontratës me LRP nr.7717/2025 dhe Ref. nr.2202/2025 me të cilën ka kërkuar leje për ndërtimin e objektit - Afarist-Depo me etazhitet P+1.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Në kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuara nga Drejtoria e Inspekcionit – inspektoriati i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;



- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga kproejktuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi: **Neshat Gashi (qiradhënës) pronarë i ngastrës P-71813046-01923-17 Zk.Lubizhdë në njërën anë dhe në anën tjetër investitor “Treang SH.P.K” (qiramarrës) sipas kontratës me LRP nr.7717/2025 dhe Ref. nr.2202/2025** ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërtimore për **objektin –Afarist-Depo.**

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:


- Njoftim për plotësim të dokumentacionit
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Pëlqimi nga Kom.”Ekoregjioni”.
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Pëlqimi nga KRU ”Dukagjini-Radoniqi” Sh.A.Gjakove.
- Pëlqimi nga Drejtoria e Sherbimeve Publike-sektori i komunikacionit
- Pëlqimi nga Drejtoria e Emergjences dhe Sigurise.
- Leja Mjedisore Komunale.
- Kater kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.


DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Nr.04-351/02-46868 dt: 29.04.2026

Bashkëpunëtor profesional:



Gazmend Berisha, Msc.ndërt



DREJTORI:



Florent Ukaj, ecc.dip.

